



UNOSEK/PR/8  
E mërkurë, 31 maj 2006

## **Delegacionet e Prishtinës dhe Beogradit diskutojnë çështjet ekonomike të statusit**

**Vjenë** – Delegacionet nga Prishtina dhe Beogradi sot i kanë mbajtur në Vjenë bisedimet e drejtpërdrejta mbi çështjet ekonomike të statusit. Bisedimet u mbajtën nën patronatin e Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, z. Martti Ahtisaari dhe bisedimet u bashkëkryesuan nga zëvendësi i Emisarit Special, z. Albert Rohan dhe nga përfaqësuesi i BE-së për bisedimet për statusin, z. Stefan Lehne, i cili është gjithashtu edhe kryesues i Grupit punues për çështje ekonomike të UNOSEK-ut.

Stefan Lehne, i cili e kryesoi takimin përgatitor për takimin ekonomik tha se: “Disa nga çështjet që u diskutuan ishin të lidhura ngushtë me çështjet thelbësore të statusit dhe prandaj ishte e vështirë të trajtoheshin në këtë fazë të procesit”, dhe shtoi se: “ekzistojnë aspekte të rëndësishme me interes ekonomik si për Serbinë dhe Kosovën, dhe se disa prej këtyre çështjeve janë çështje teknike tejet komplekse”.

Z. Lehne tha se takimi ishte shumë i dobishëm meqë aty është bërë e mundur që të kuptohen më mirë qëndrimet e të dyja palëve. Megjithatë, shtoi Lehne: “në këtë fazë nuk duhet të kemi iluzione. Ekzistojnë dallime shumë, shumë të konsiderueshme të pikëpamjeve në disa prej çështjeve kryesore të rendit të ditës”.

Z. Lehne tha se për qasjen e përgjithshme të çështjes së borxhit të jashtëm ka pasur disa marrëveshje meqë Kosova është e gatshme të paguaj një pjesë të borxhit nga borxhet e huaja të Serbisë dhe Malit të Zi. “Shpresojmë se procesi i spastrimit të borxhit tani mund të lëviz përpara”, tha z. Lehne dhe apeloi te të dyja palët që ta shkëmbejnë dokumentacionin përkatës që ata e kanë me palën tjetër.

Lidhur me çështjen e pronës z. Lehne tha se: “ekziston një mospajtim fundamental në mes të palëve për disa çështje të rëndësishme”. Ai sqaroi se: “nuk është në mandatin e UNOSEK-ut as të ri-negociojë rrënjësisht legjislacionin ekonomik të Kosovës të shtatë viteve të fundit e as të ndërhyjë me menaxhimin e procesit në Kosovë”, dhe shtoi: “Detyra e procesit të statusit për çështjet e pronës është që t’i shqyrtojë mekanizmat e ekzistues të cilët duhet të garantojnë që kërkesat lidhur me pronën private apo

privatizimin të trajtohen në mënyrë korrekte edhe pas zëvendësimit të Rezolutës 1244 me ndonjë rezolutë tjetër”.

Z. Lehne tha se të dyja palët kanë pasur gjithashtu mundësinë që të shtrojnë në tavolinë tema tjera me interes për t'i diskutuar në procesin për çështjen e të statusit. Beogradi paraqiti çështjen e borxhit të brendshëm derisa Prishtina ngriti çështjen e dokumentacionit kadastral, të drejtat pensionale, problemin e llogarive devizore dhe idenë për një mekanizëm të përgjithshëm për kompensime për t'u marrë me kërkesat e palëve privat. Të dyja palët u pajtuan se duhet të shkëmbejnë informata përkatëse dhe se do t'i kthehen kësaj çështjeje në një fazë më të vonshme.

Z. Rohan njoftoi se ekspertët teknik të UNOSEK-ut do ta mbajnë një takim nesër në Vjenë me anëtarët e Delegacionit të Prishtinës mbi decentralizimin, e në veçanti për krijimin e komunave të reja. Ekspertët e UNOSEK-ut do të shkojnë gjithashtu edhe në Beograd gjatë ditëve të ardhshme për ta diskutuar çështjen e njëjtë.

Zëvendësi i Emisarit Special njoftoi se UNOSEK-u është tani duke themeluar grupin punues për krijimin e zonave mbrojtëse të objekteve fetare. Në këtë grup përfshihen UNOSEK-u, përfaqësuesit e Beogradit, Prishtinës, të Kishës Ortodokse Serbe si dhe ekspertë nga Këshilli i Europës dhe UNESCO-ja. Z. Rohan shtoi: “Shpresojmë ta dërgojmë Grupin punues në rajon në javën e 12 qershorit”.

Zëvendësi i Emisarit Special njoftoi se, sot, Qeveria në Prishtinë e ka miratuar protokolin për kthimet e qëndrueshme, i cili duhet të nënshkruhet nga Beogradi. Ndonëse ky protokol nuk është në kompetencë të UNOSEK-ut, në Vjenë është arritur një marrëveshje për çështjen dytësore të mbledhjes së mbajtur në Vjenë më 23 maj 2006 falë punës së zellshme të anëtarëve të të dyja delegacioneve, sqaroi z. Rohan. Nënshkrimi do të bëhet në Prishtinë.